

RIDEFINIMI I ROLIT TË VIKTIMËS NË TË DREJTËN PENALE BASHKËKOHORE PËRMES REFORMAVE LIGJORE

Besa ARIFI*

Abstrakt:

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë zhvillimin e rolit të viktimës në të drejtën ndërkombëtare dhe atë ndërkombëtare penale duke filluar nga evoluimi i rolit të individit dhe të drejtave të tij nga Vestfalia 1648 deri në Luftën e Dytë Botërore për të vazhduar me kornizën normative të të drejtave të viktimës në periudhën bashkëkohore. Në këtë aspekt, do të analizohen dokumentet kryesore ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e viktimës. Si që do të konstatohet në punim, konventat dhe deklaratat themelore për të drejtat e njeriut promovojnë fare pak të drejta për viktimën. Me përjashtim të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore si dhe Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut, dokumentet tjera të kësaj natyre nuk flasin fare për të drejtën e individit të fitojë kompensim për dëmin që i është shkaktuar nga një vepër penale. Në anën tjetër, statutet e dy tribunaleve ndërkombëtare penale ad hoc (ai për ish-Jugosllavinë dhe për Ruandën) si dhe statuti i Gjykatës Penale Ndërkombëtare promovojnë një numër të konsiderueshëm të të drejtave mjaft të rëndësishme për viktimat, duke kërkuar që parimet e gjykimit të drejtë të zbatohen “me respekt të plotë ndaj të drejtave të të akuzuarit por edhe në konsideratë me të drejtat e viktimës...”. Gjykata Ndërkombëtare Penale në veçanti promovon masa serioze për mbrojtje dinjitoze dhe kompensim të drejtë për viktimat, gjë që do të prezantohet në detaje në këtë punim.

Fjalët kyç: *E drejta restorative, viktima, pjesëmarrja e viktimës, dëshmitari, mbrojtja e viktimës dhe dëshmitarit.*

1. Hyrje

Tendenca e re që gjen zhvillimin e saj në të drejtën bashkëkohore penale e që ka për qëllim theksimin e rolit të viktimës në të drejtën penale në përgjithësi duke përfshirë këtu edhe të drejtën ndërkombëtare penale si dhe procedurën penale; i shpalos rrënjët e saja falë realitetit historik që ka ekzistuar deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Megjithë që lëvizjet për vetëdijesim lidhur me të drejtat e viktimës paraqiten si lëvizje moderne dhe bashkëkohore;

* Qendra për të Drejtat e Njeriut, Fakulteti Juridik; Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, Maqedoni.

viktimat e krimeve, si që shpjegojnë ekspertët, jo gjithnjë kanë qenë të detyruar t'i realizojnë të drejtat e veta në këtë mënyrë, pasi që deri vonë, vetë viktimat kishin të drejtën dhe përgjegjësinë ta ndjekë dhe persekutojë personin që i ka shkaktuar dëm dhe pikërisht viktimat deri vonë e ka mbajtur barrën e provës së fajësisë së kryerësit të krimit. [1-6]

Ky realitet ishte evident gjithkund deri në filltet e mesjetës kur sistemi inkuizitorial erdhi në shprehje. Nga kjo kohë, realiteti në fjalë vazhdoi të ekzistonte në vendet me sistem anglo-sakson ku viktimës i sigurohej një rol mjaft aktiv në procedurën penale duke e shndërruar në këtë mënyrë përndjekjen e një krimi në një “raport kryesisht privat mes viktimës dhe kryerësit të veprës penale”. [2] Në shekullin XIX paraqitet një doktrinë e re sipas të cilës vepra penale nuk mund të trajtohet si çështje private mes viktimës dhe kryerësit pasi që ajo prek dhe dëmton thellësisht interesin publik të shtetit. Kjo qasje ishte e evidente në shtetet me sistem juridik kontinental që me paraqitjen fillestare të sistemit inkuizitorial. Por në shekullin XIX kjo qasje fitoi përkrahjen e përgjithshme edhe në vendet me sistem juridik anglo-sakson, duke e vendosur kështu viktimën në një pozitë sekondare. Si rezultat i paraqitjes së shkollës antropologjike-pozitiviste të Lombrozos, kryerësi i veprës penale u ngrit në njërin ndër subjektet primare dhe më se të rëndësishme për t'u studiuar në të drejtën penale dhe në kriminologji, duke i ridrejtuar në këtë mënyrë përpjekjet e shtetit drejt dy qëllimeve kryesore: rrualtjen e interesit publik, dhe trajtimin e kryerësit me qëllim të risocializimit të tij. Mendimi i mëposhtëm i Kennard-it sikur u harrua:

Në çdo krim të kryer ka të paktën dy viktimat: Shoqëria vuan si pasojë e shkeljes së rregullave të saja, ndërsa viktimat aktuale vuan dëmin aktual ndaj personalitetit ose pronës së tij (pp: 417, [1]). Për më tepër se një shekull viktimat paraqet jo më shumë se “një palë pasive, roli i së cilës kufizohet vetëm në vualtjen e dëmit”. [4] Duke qenë gati tërësisht e përjashtuar nga procedura penale, viktimat zakonisht bëhet subjekt i viktimizimit sekondar që rezulton me mos-raportimin e krimeve. Megjithë që është e qartë që reagimi i shtetit ndaj kryerësit të një veprës penale inspirohet fillimisht nga padrejtësia që i është shkaktuar viktimës; sërish, qëllimi kryesor i drejtësisë penale mbetet shpagimi dhe parandalimi i krimit.

Sa i përket të drejtës ndërkombëtare penale dhe rolit të viktimës aty, gjëja e parë që duhet të qartësohet është se pasi që kjo paraqet një disiplinë të re dhe në zhvillim, ku kombinohen parimet anglo-saksone dhe kontinentale, edhe aty identifikohen problemet e përmendura lidhur me përfaqësimin e viktimës në sistemin gjyqësor duke shtuar këtu edhe aspektin e të

drejtave të njeriut. Sidoqoftë, ashtu si që do të shihet edhe më poshtë, ndryshimet kryesore lidhur me pozitën e viktimës, të paktën formalisht, janë realizuar pikërisht në të drejtën ndërkombëtare penale megjithë që problemet vazhdojnë të ekzistojnë. Ky punim ka për qëllim të bëjë një krahasim mes tendencave për theksimin dhe implementimin e të drejtave të viktimës dhe kompensimit të saj në të drejtën anglo-saksone dhe kontinentale në mënyrë që të fitohet një figurë e qartë lidhur me garantimin e këtyre të drejtave në drejtësinë ndërkombëtare penale.

2. Roli i viktimës në dy sistemet më të mëdha juridike

2.1 Viktimat në sistemin anglo-sakson – mënyrat e përfshirjes aktive të tyre në procedurën penale

Sistemi anglo-sakson i përfshin në mënyrë aktive të gjitha palët në proces dhe duke iu falënderuar formës specifike të procesit gjyqësor, parimet e kontradiktës dhe të barazisë së armëve arrijnë kulmin e tyre. Sidoqoftë, roli i viktimës në këtë sistem që në shikim të parë duket shumë demokratik dhe transparent, nuk është aspak i lakmueshëm duke marrë parasysh aspektet e mëposhtme.

Së pari, roli i viktimës në fazën e ndjekjes së kryerësit të veprës penale është shumë i kufizuar dhe në këtë mënyrë, krijohet përshtypja sipas të cilës viktimat portretizohet si një palë pasive që paraqitet vetëm për të dëshmuar në rolin e dëshmitarit. Autorja Sebba [6] i referohet këtij fakti si “zhdukja e viktimës”, duke theksuar që për dallim nga procedura tradicionale penale anglo-saksone, viktimat, si njëra ndër palët origjinale është zhdukur nga procesi bashkëkohor penal në vendet anglo-saksone. Ashtu siç thekson edhe Fenwick [2], ky pozicion reflekton kuptimin që interesi privat i viktimës është i subordinuar ndaj interesave publike dhe në krahasim me to ai mbetet periferik. Thellësisht pajtohem me mendimin që procesi i persekutimit penal të një kryerësi qëndron më lartë nga interesat private dhe për shkak të seriozitetit të konsiderueshëm ai proces duhet të drejtohen nga shteti, por nuk mendoj që është e drejtë që viktimat të marginalizohen në një mënyrë kaq jo të natyrshme pasi që gjykoj që kjo paraqet kryerjen e një padrejtësie tjetër me qëllim të arritjes së një farë drejtësie.

Së dyti, viktimat zakonisht është e përjashtuar nga procesi i quajtur “plea bargaining” gjë që shpesh konsiderohet si tërësisht jo e drejtë për të sepse paraqet një tjetër mënyrë të mbrojtjes së interesave shtetërore në llogari të interesave të viktimës [1]. Ky proces është i ngjashëm me procesin e ndërmjetësimit në të drejtën kontinentale me dallimin që në të drejtën anglo-

saksone, është një veprim normal, i arsyeshëm dhe i dëshirueshëm që palët të negociojnë rreth pranimit të fajit nga ana e kryerësit me qëllim që të mos shkohet në proces gjyqësor ose që i njëjti të lehtësohet. Në përkthim literal “bargaining” nënkupton “bërjen pazar” gjë që duket shumë e pazakonshme për një jurist të sistemit kontinental për të cilin parimi i të vërtetës materiale është mbi të gjitha. Për më tej, procesi i negociimit të fajit (plea bargaining) në të drejtën anglo-saksone paraqet një proces shumë të mbyllur dhe të izoluar ku zgjidhet një e keqe më e vogël në vend të një të keqeje më të madhe. Por kjo qasje vjen në konsideratë vetëm për institucionet shtetërore. Sa i përket qasjes së viktimës, ky proces nuk paraqet gjë tjetër përpos një neglizhence totale sa i përket interesit dhe sigurisë së saj dhe gjithçka tjetër që ajo e konsideron si drejtësi.

Së treti, duhet patjetër pasur parasysh që si që është përmendur më lartë, procesi gjyqësor anglo-sakson përfshin edhe të ashtuquajturin pyetje të kryqëzuar ndaj të gjithë dëshmitarëve, duke përfshirë këtu edhe viktimat. Pyetja direkt i kryqëzuar ka hasur në kritika serioze pasi që viktima në veçanti, por gjithashtu edhe dëshmitari, mund të ndjehet i kërcënuar ose i manipuluar në këtë formë të marrjes në pyetje veçanërisht duke pasur parasysh që pyetjet kontradiktore të palës kundërshtare zakonisht kanë për qëllim të vetëm diskualifikimin e dëshmisë së viktimës ose dëshmitarit si të parëndësishme, e jo gjetjen e të vërtetës materiale [7]. Kjo paraqet problem të veçantë kur viktimat e krimeve “delikate” duhet të dëshmojnë për sa i përket eksperiencës së tyre (krimet seksuale, keqpërdorimi i fëmijëve, etj.) Pyetja e kryqëzuar shpesh herë është tepër e vështirë dhe e padurueshme për to ndërsa në anën tjetër, shtyrjet e shumta të seancave gjyqësore, si dhe koha dhe paratë e humbura aty e bëjnë viktimën të mendojë a ia vlen në të vërtetë i gjithë ky mund dhe shpenzim.

Së katërti, interesat e viktimës kanë zakonisht vetëm vlerë këshilluese dhe dytësore në procesin e marrjes së vendimit gjyqësor. Si edhe në fazat e mëparshme, janë interesat e shtetit ata që konsiderohen si më të rëndësishmet. Së pesti, kërkesa e viktimës për kompensim të dëmit, e cila paraqet idenë kryesore të tendencës bashkëkohore për drejtësi restorative, nuk mund t’i bashkëngjitet procesit penal por duhet të zhvillohet si çështje e veçantë civile gjë që kërkon më tepër kohë, mjete financiare dhe mund.

Gjithçka që u përmend më lartë, e rritet rëndësinë e konceptit të viktimizimit të dyfishtë dhe jep një sqarim parcial por shumë të rëndësishëm të arsyes së nivelit të ulët të raportimit të krimeve dhe paraqitjes në gjykata dhe në përgjithësi arsyet e nivelit të ulët të ndjekjes së

drejtësisë përmes proceseve penale që duken të jenë të gjata, të shtrenjta dhe ndoshta edhe të padrejta sa u përket të drejtave të viktimës. Këto janë disa nga arsyet që ekspertët i theksojnë duke thirrur në ndryshime rrënjësore që do të mundësonin “kthimin e viktimës” si që do të ishte shprehur Kennard [1] me një participim më aktiv në sallën e gjyqimit, duke kërkuar edhe mundësi të konstituimit të një instituti juridik të ashtuquajtur “vetoja e viktimës” [1] në mënyrë që të garantohet ndikimi i interesave të viktimës në vendimet gjyqësore. Sado radikale në dukje të parë, kjo ide përfaqëson zërin e viktimës së heshtur dhe të frustruar e cila mendon thellë përpara se të marrë kurajën e inicimit të një procesi gjyqësor duke pasur parasysh së kështu si qëndrojnë punët tani, ky proces i ofron asaj më tepër keqkuptim dhe keqtrajtim se sa drejtësi për dëmin që i është shkaktuar.

2.2 Roli i viktimës në vendet me sistem juridik kontinental

Vendet me sistem juridik kontinental kryesisht e zbatojnë procesin gjyqësor që ka evoluar nga sistemi inkuizitor. Edhe pse në shikim të parë ky sistem krijon përshtypjen e një procesi më pak transparent për palët e përfshira duke e koncentruar fuqinë në duart e gjyqtarit profesional i cili e kontrollon rrjedhën e procesit, në fakt, sa u përket të drejtave të viktimës, ky sistem ofron tri mënyra kryesore të garantimit të një gjykimi të drejtë për to.

Së pari, pyetja e kryqëzuar që paraqitet si shumë problematike dhe diskurajuese në sistemin anglo-sakson, në atë kontinental kontrollohet nga gjyqtari në mënyrë që të krijohet kujdes për llojin e pyetjeve të parashtruara gjatë pyetjes e gjitha kjo me qëllim të mbrojtjes së dëshmitarit ose viktimës nga pyetjet e padrejta, të paqarta ose kapriçoze. Të paktën teorikisht, kjo i jep viktimës një pozitë shumë më të mirë në krahasim me pozitën e saj në sistemin anglo-sakson.

Së dyti, procesi i negociimit të fajit (*plea bargaining*) nuk është dhe aq i inkorporuar në sistemin kontinental. Është e qartë që ekzistojnë dispozita sipas të cilave bëhen përjashtime në ndjekjen ose dënimin e një personi që pranon të bashkëpunojë me organet e shtetit nëpërmjet të zbulimit të informative rreth një ndërmarrjeje më të madhe kriminale, por kjo kryesisht realizohet në rastet e rënda të krimit të organizuar, pra një përjashtim i tillë nuk paraqet një praktikë të natyrshme dhe të përditshme si që është rasti në sistemin anglo-sakson ku shumë pak raste e arrijnë gjykimin si pasojë e përdorimit të shpeshtë dhe të zakonshëm të institutit *plea bargaining*.

Së treti dhe më me rëndësi, procesi civil për kompensimin e dëmit të shkaktuar ndaj viktimës në sistemin kontinental është i bashkuar me procesin kryesor penal gjë që mundëson viktima ta realizojë të drejtën e kompensimit në një mënyrë më pak të komplikuar, më pak të shtrenjtë dhe më të shpejtë [8].

Edhe pse këto garanci krijojnë një përshtypje mjaft pozitive për pozitën e viktimës në sistemin kontinental, roli i saj pasiv dhe subsidiar në procesin e ndjekjes së kryerësit vazhdon të mbetet evident. Edhe këtu, viktima ende ka vetëm pozitën e dëshmitarit por jo edhe të subjektit të pavarur në procesin penal. Sistemi kontinental ndoshta ofron bazament më të fortë teorik për realizimin e të drejtave të viktimës, por megjithatë, mbetet shumë për të bërë ne implementimin praktik të këtyre të drejtave me qëllim të sigurimit të një pozite të garantuar për personat që kanë vuajtur aq shumë dëm. Kjo veçanërisht ka të bëjë me vendet në tranzicion që në fakt janë vende me sistem juridik kontinental dhe si të tilla, në legjislacionet e tyre i parashohin të gjitha dispozitat karakteristike kontinentale lidhur me mbrojtjen e interesit të viktimës (edhe në qoftë se mungon ndonjë dispozitë e tillë, e njëjta kalohet pa hezitime nga ligjvënësi në mënyrë që të përshpejtohet procesi i euro-integrimeve); në realitet këto shtete realizojnë shumë pak nga këto të drejta të garantuara. Në këtë kontekst, do të kisha dashur të përmend një rast në Republikën e Maqedonisë [9] ku dy persona të akuzuar për dhunimin e dy të miturave (njëra nga të cilat ishte edhe e virgjër) fituan vetëm gjoha financiare dhe nuk u ballafaquan me dënimin me burg falë faktit që gjykata ishte mjaft e korruptuar që të lejonte jo vetëm injorimin total të të drejtave të viktimave por edhe të vente në rrezik interesin dhe sigurinë publike duke mundësuar që dhunues të vërtetuar të ecin lirshëm. Prandaj, hapësira mes kalimit të një ligji dhe implementimit real të tij duhet marrë patjetër në konsideratë shumë seriozisht në mënyrë që të mbrohen viktimat që kanë vuajtur aq shumë dëm, por njëherësh, me qëllim të shndërrimit të komunitetit në një vend të sigurtë për të jetuar.

3. Viktimat, të drejtat e njeriut dhe e drejta ndërkombëtare penale

Në qoftë se për një moment e ridrejtojmë vëmendjen tonë drejt studimit të pozitës së viktimës dhe rolit të saj në të drejtën ndërkombëtare dhe atë ndërkombëtare penale, do të konstatohet realiteti i poshtëshënuar: Gjatë ekzistencës shekullore të personalitetit juridik të viktimës në të drejtën nacionale penale qoftë si subjekt primar ose subsidiar, për shekuj të tërë viktima (si një individ) ishte e padukshme dhe e parëndësishme për të drejtën ndërkombëtare. Si që deklaroi Bassiouni:

Nga paqja në Vestfali më 1648 e deri në Luftën e Dytë Botërore, shteti ka qenë subjekti i vetëm dhe nga këtu primar i të drejtës ndërkombëtare (pp. 90, [10]). Vetëm pas Luftës së Dytë Botërore individi filloi të shfaqet si subjekt i mbrojtjes direkte në të drejtën ndërkombëtare dhe pikërisht në këtë kohë filloi edhe periudha e përgjegjësisë individuale penale ndërkombëtare. Pra, mund të konstatohet se sfera e të drejtave të njeriut dhe e drejta ndërkombëtare penale në esencën e tyre filluan të zhvillohen paralelisht pas Nurembergut dhe Tokios. Të drejtat e individit (ende pa e përmendur në mënyrë specifike viktimën) u shndërruan në një ndër preokupimet kryesore të komunitetit ndërkombëtar që kërkonte mekanizma të ndryshme të implementimit me qëllim të garantimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut (trupa monitorues dhe procedura për pranimin e ankesave, të cilat fatkeqësisht u treguan si jo të mjaftueshme për arritjen e mbrojtjes së dëshiruar të të drejtave të njeriut në qoftë se i marrim parasysh shkeljet flagrante të këtyre të drejtave dhe nivelin e lartë të viktimizimit që u paraqit në 50 vitet e fundit. Bassiouni [10] thekson që pas Luftës së Dytë Botërore u zhvilluan edhe 250 konflikte nga më të ndryshmet ku u vranë 170 milionë njerëz). Duke u nisur nga kjo, nevoja për një pjesë të specifikuar të njohurive juridike që do t'u dedikohet pikërisht viktimave, të drejtave të tyre dhe kompensimit të dëmit të shkaktuar ndaj tyre është më imanente se kurrë.

Dokumentet ndërkombëtare që japin kornizën e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së individit si: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike të njeriut, Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, Konventa kundër torturës dhe formave të tjera të trajtimit të vrazhdtë dhe çnjerëzor, Konventa për të drejtat e fëmijëve; si dhe konventat regjionale si Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, Konventa Amerikane për të drejtat e njeriut, Karta Afrikane për të drejtat e njeriut dhe të popullit, promovojnë fare pak të drejta për viktimat. Me përjashtim të Konventës Evropiane dhe asaj Amerikane, dokumentet tjera nuk flasin për të drejtën e një individi për kompensim të dëmit që i është shkaktuar me një vepër penale. Përkundër vërejtjes që këto konventa janë adoptuar shumë kohë më parë, para disa dekadave, për mendimit tim, është i patolerueshëm fakti që këto dokumente nuk janë plotësuar me amendamente sa i përket çështjes së sigurimit të një mbrojtje dinjitoze të të drejtave të viktimës. Dokumenti i parë ndërkombëtar dhe universal që ka të bëjë në mënyrë specifike me të drejtat e viktimave dhe procedurën e kompensimit të dëmit ndaj tyre është Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimeve dhe të Abuzimit të Pushtetit (1985) e adoptuar në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të

Bashkuara. Përkrah definimit të kuptimit “viktimë” [11] ky dokument promovon edhe disa të drejta të tyre si:

- Qasje deri te organet e drejtësisë dhe trajtim të drejtë ndaj tyre (që mes tjerash nënkupton ndihmën juridike dhe njoftimin në kohë për të gjitha aspektet procedurale),
- Restituim (rikthimi i pronës, kompensimi i dëmit, restorimi i të drejtave, etj.),
- Kompensim (i siguruar nga shteti kur mjetet financiare të kryerësit janë të pamjaftueshme për këtë gjë) dhe
- Ndihmë (materiale, mjekësore, psikologjike dhe sociale).

Sidoqoftë, në aspektin juridik, duke qenë se ky dokument është vetëm një Deklaratë e parimeve kryesore, nënkuptohet që mekanizmat e implementimit të tij janë mjaft të dobët. Në qoftë se e kemi parasysh dallimin mes Deklaratës universale të të drejtave të njeriut dhe Paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike të njeriut është më se e qartë që dokumenti i dytë ka forcë shumë më të madhe imperative dhe obliguese se sa i pari. Prandaj, për mendimin tim, të drejtat e viktimës duhet të rregullohen përmes një dokumenti ndërkombëtar obligativ dhe imperativ për të gjitha shtetet pale, me mekanizma të qarta zbatuese dhe sanksione për shtetet që dështojnë në aplikimin e këtyre rregullave, gjë që është e pamundur të realizohet vetëm me një Deklaratë, sado universale qoftë ajo. Të gjitha dokumentet tjera në këtë sferë të të drejtave të njeriut mbetën në fazën e “propozimit” [12,13] për dekada të tëra, që tregon për procesin e gjatë dhe të lodhshëm të realizimit të të drejtave të viktimës. Sidoqoftë, adoptimi i Parimeve bazë dhe udhëzimeve për të drejtën e kompensimit për viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare në Prill të vitit 2005 len të kuptohet që kjo praktikë e injorimit të të drejtave të viktimës si kategori bazë e të drejtave të njeriut shkon drejt ndryshimit.

Në anën tjetër, statutet e dy tribunalëve ndërkombëtare penale *ad hoc* (Tribunali i Hagës për ish-Jugosllavinë dhe ai për Ruandën) si dhe Gjykata Ndërkombëtare Penale promovojnë në dokumentet e tyre themelore juridike një numër të madh të të drejtave të rëndësishme për viktimën, duke kërkuar në këtë mënyrë për shembull, realizimin e parimit për gjykim të drejtë “përmes respektimit të plotë të të drejtave të të akuzuarit dhe në kontekst me mbrojtjen e viktimës...” [14]. Kjo tendencë për sigurimin e një balance mes të drejtave të viktimës dhe atyre të të akuzuarit duhet parë si një karakteristikë mjaft e rëndësishme dhe unike e gjykatave penale ndërkombëtare që për dallim nga praktika e gjertanishme e të drejtave të njeriut për

promovimin e zakonshëm vetëm të të drejtave të të akuzuarit për gjykim të drejtë duke e anashkaluar faktin që një gjykim i tillë nuk mund të jetë i drejtë duke i respektuar vetëm të drejtat e njërës palë, pra të drejtat e viktimës duhet patjetër të kyçen në këtë sistem.

Edhe pse eksperiencat e Tribunalit për ish-Jugosllavinë dhe atij për Ruandën janë karakterizuar shpesh si dështim të përpjekjeve për kompensimin e viktimave [10], teorikisht, ato paraqesin një qasje të re ndaj të drejtave dhe trajtimit të viktimës para një tribunali. Le ta përkujtojmë faktin që në rastin Prokurori kundër Tadiqit (*Prosecutor v. Tadić*) në Gjykatën penale ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, edhe anonimiteti i plotë i viktimës dhe dëshmitarit ndaj të akuzuarit dhe këshillit të tij si masë më radikale për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve u implementua [15]. Edhe Gjykata Ndërkombëtare Penale promovon masa serioze për trajtimin me respekt dhe kompensim ndaj viktimave që do të sqarohen më poshtë. Duke u nisur nga kjo, është më se e rëndësishme që këto dy sfera të mbrojtjes së të drejtave të njeriut duke përfshirë edhe mbrojtjen e të drejtave të viktimës nga njëra anë, dhe e drejta penale ndërkombëtare në anën tjetër të punojnë në të njëjtin drejtim duke e plotësuar njëra tjetrën në mënyrë që të arrihet qëllimi i përbashkët për inicimin e një mënyre të përgjithshme për ti obliguar shtetet që ti inkorporojnë këto rregulla në legjislacionet e tyre.

4. Gjykata Penale Ndërkombëtare – Drejt një procesi të ri penal ndërkombëtar

Gjykata Penale Ndërkombëtare është institucion që në juridiksionin e tij ka promovuar të drejta revolucionare për viktimat e krimeve. Kjo Gjykatë e ka përdorur eksperiencën e dy tribunalëve të mëhershme *ad hoc* për ish-Jugosllavinë dhe Ruandën për t'i identifikuar nevojat e viktimës si dhe për t'i gjetur mënyrat më të mira për t'u ndihmuar atyre të fitojnë kompensim për dëmin që u është shkaktuar në mënyrë që ta rindërtojnë jetën e tyre dhe, që është më me rëndësi, të sigurojnë pjesëmarrje aktive në procesin gjyqësor. Balanca mes të drejtave të të akuzuarit dhe atyre të viktimës është përmirësuar dukshëm nëpërmjet të këtij institucioni. Kjo gjë mund të observohet përmes tri kategorive të dhënies ndihmë viktimave.

4.1 Participimi

Për dallim nga eksperiencat e legjislacioneve nacionale dhe atyre të tribunalëve të përmendura *ad hoc*, GjNP promovon të drejta të qarta për participimin e viktimës në të gjitha stadet e një procesi penal [16]. Ky fakt historik i siguron viktimës të drejtën t'i prezantojë mendimet dhe observimet e veta përpara Gjykatës, në të shumtën e rastit përmes një përfaqësuesi juridik “në një mënyrë që nuk përmban paragjykime ndaj të akuzuarit dhe nuk është në kundërshtim me

të drejtën e tij për gjykim të drejtë”. [16] Kjo paraqet mundësinë që zëri i viktimës të dëgjohet duke mundësuar krijimin e ndjenjës së participimit të tyre në procesin e kërkimit të të vërtetës dhe realizimit të drejtësisë. Edhe pse një prezantim i tillë i mendimeve dhe observimeve të viktimës nuk paraqet një obligim ligjor për këshillin gjyqësor në procesin e marrjes së vendimit sa i përket rastit të caktuar, megjithatë, një gjë e tillë paraqet një mënyrë të rëndësishme të faktorizimit dhe publikimit të opinionit dhe qasjes së tyre lidhur me rastin.

4.2 Kompensimi

Ky njëherësh është edhe inovacioni më revolucionar i GjNP sa u përket të drejtave të viktimës duke pasur parasysh faktin që për herë të parë në historinë e njerëzimit një gjykatë penale ndërkombëtare ka fuqinë të urdhërojë një individ të paguajë kompensimin e një individi tjetër [17]. Një trup i veçantë është krijuar po për këtë qëllim (Fondi i Mirëbesimit për Viktimat - Trust Fund for Victims) në mënyrë që të arrihet balanca kompensim-restitucion.

4.3 Mbrojtja

Së fundi, për dallim nga tribunalët *ad hoc*, GjNP ofron mbrojtje më serioze për viktimat dhe dëshmitarët duke promovuar bashkëpunimin me shtetet anëtare lidhur me themelimin e programeve për mbrojtje të dëshmitarëve dhe viktimave. Përmenden edhe mënyra dhe forma të reja të mbrojtjes së këtyre kategorive por nuk aplikohen masat radikale të mbrojtjes si anonimiteti total i viktimës ose dëshmitarit ndaj të akuzuarit ose këshillit të tij.

Kjo njëherësh edhe i përmbyll përpjekjet e këtij institucioni të krijojë një përshtypje të re për viktimat e krimit deri diku si subjekte direkte të procedurës penale ndërkombëtare, përpjekje këto që meritojnë respekt dhe përkrahje duke pasur parasysh nevojën për baraspeshën retributivo-restitutive mes të drejtave të viktimës dhe të të akuzuarit.

5. Të drejtat e viktimës sipas ligjeve të Republikës së Maqedonisë

Duke pasur parasysh sa është thënë më lartë lidhur me tendencat bashkëkohore për ridefinimin e pozitës së viktimës në të drejtën penale, lehtë mund të konstatohet se ligjet e Maqedonisë që kanë të bëjnë me çështjet penale janë plotësisht të orientuara drejt kryerësit të veprës penale. Në qoftë se analizohet Kodi Penal i RM-së në këtë aspekt, gjëja e parë që do të konstatohet është se termi “viktimë” nuk paraqitet fare në pjesën e përgjithshme të këtij kodi (ashtu si edhe në shumë vende tjera me sistem juridik kontinental, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë – në vazhdim KPRM – përmban dy pjesë, pjesën e përgjithshme që ka të bëjë me konceptet e përgjithshme të krimit, përgjegjësisë penale dhe sanksioneve penale dhe pjesën e

posaçme që ka të bëjë me veprat konkrete penale); që do të thotë se viktimë nuk paraqet një subjekt të veçantë dhe të pavarur të të drejtës penale. E gjithë pjesa e përgjithshme e KPRM ka të bëjë kryesisht me kryerësin dhe të drejtat e tij. Kështu, po të merret në konsideratë neni 31 i KPRM [18] do të kuptohet që qëllimet e vetme të sanksioneve penale janë retribucimi, parandalimi specifik dhe i përgjithshëm (ndalimi i kryerësit ta përsërisë veprën penale si dhe ndalimi i të tjerëve ta kryejnë të njëjtën) dhe rehabilitimi i kryerësit. Restituimi dhe kompensimi i viktimës nuk përmenden fare si qëllime të sanksionit penal. Është e qartë që segmenti restorativ i drejtësisë penale në Maqedoni akoma dukshëm mungon edhe ligjërisht. I vetmi termin që është i përafërt me kategorinë e viktimave identifikohet në nenin 99 të KPRM [18] që flet mbi të drejtën e personit të dëmtuar të kërkojë restituimin e pronës së tij. Kjo është e gjitha. Si që është përmendur më lartë, restituimi i pronës së dëmtuar është vetëm njëri nga elementet konstitutive të të drejtave të viktimës në teorinë bashkëkohore të cilat kërkojnë një angazhim më evident dhe të dukshëm të viktimës duke përfshirë këtu participimin por edhe mbrojtjen e tij. Sa i përket terminologjisë, për mendimin tim termi “person i dëmtuar” që përdoret si në KPRM ashtu edhe në Ligjin për Procedurë Penale të Republikës së Maqedonisë (në vazhdim LPPRM), është shumë më i ngushtë se termi “viktimë” pasi që ai termin kufizohet vetëm tek personat që kanë vuajtur dëm material dhe është kryesisht i drejtuar në kompensimin material apo lukrativ të dëmit.

Termi “person i dëmtuar” paraqitet më shpesh në LPPRM [19] duke u dhënë mundësinë këtyre personave të dalin në skenën e drejtësisë si që do isha shprehur në mënyrë ironike, kur asgjë tjetër nuk ka sukses. Pra, “personi i dëmtuar” ose “paditësi privat” janë palë subsidiare e jo primare në një proces penal. Është e qartë që roli i prokurorit është shumë i rëndësishëm dhe esencial, sidoqoftë, në mënyrë që realizimi i standardeve të drejtësisë të bëhet i mundur, edhe të drejtat e viktimës dhe trajtimi i drejtë i saj duhet të kuptohet si thelbësor. Jam më se e bindur se kjo qasje e orientuar tërësisht nga kryerësi duhet të ridefinohet dhe të drejtat e viktimës duhet të përcaktohen qartësisht pikërisht si janë të përcaktuara qartësisht të drejtat e të akuzuarit. Që të arrihet kjo, së pari viktimë duhet të pranohet si palë direkte në proces dhe të realizohen të drejtat themelore të saj: participimi, mbrojtja dhe restituimi. Kjo do të duhej të ishte fryma e reformave në legjislacionin penal të Maqedonisë që janë duke u zhvilluar tani. Ka pasur përpjekje administrative të theksimit të rolit dhe brishtësisë së viktimave të disa krimeve të veçanta si Trafikimi me qenie njerëzore ose Dhuna në familje (kryesisht programe të qeverisë dhe OJQve të ndryshme për mbrojtje dhe strehim të viktimave), sidoqoftë, për mendimin tim kjo qasje e kufizuar ndaj një çështjeje kaq të rëndësishme duhet ngritur në një

nivel më të lartë me anë të ridefinimit të dispozitave ligjore në një mënyrë që do të ishte e drejtë për “të dy anët e tregimit”.

6. Konkluzione

Mund të vërehet që viktima ngadalë por sigurtë depërton në sistemin e të drejtave të njeriut dhe në atë të drejtësisë nacionale dhe ndërkombëtare penale që paraprakisht ishin tërësisht të mbyllura për interesat e saja. Kjo mund të ngrejë shpresën e përgjithshme që përfundimi i pozitës së viktimës dhe të drejtat e saja do të jenë njëra ndër strategjitë kryesore të zhvillimit të ardhshëm të të drejtës penale. Ideja është që të kompletohet tabloja e qëllimeve të të drejtës penale duke e ruajtur retribuimin dhe preventivën speciale dhe gjenerale si qëllime tradicionale, duke shkuar më tej me qëllimin e rehabilitimit të kryerësit dhe riaftësimin e tij për jetë normale dhe të ligjshme pas vuajtjes së dënimit përmes masave risocializuese dhe duke përfunduar me zhvillimin e aspektit restorativ të procesit penal në tërësi përmes së arritjes së një balance në raportin viktimë-kryerës duke kërkuar mënyra të restaurimit të dëmit varësisht nga mundësitë.

Në këtë rrugë të gjatë të ripozicionimit të viktimës dhe rifitimit të kufizuar të fuqisë dhe rëndësisë që ajo kishte në të kaluarën, por gjithnjë duke pasur parasysh interesin publik, disa gjëra duhen marrë në konsideratë:

- Principet e sistemit anglo-sakson dhe atij kontinental duhen kombinuar në mënyrë që të sigurohet trajtim i drejtë si për kryerësin ashtu edhe për viktimën, veçanërisht në institucionet si GjNP që me anë të sistemit të tyre hibrid të procesit penal ofrojnë hapësirë të mjaftueshme për ti bërë kombinimet e nevojshme për sigurimin e një pozite më të volitshme për viktimën. Të drejtat e viktimës duhen konsideruar si të barabarta me të drejtat e të akuzuarit. Është evidente tendenca e përgjithshme e theksimit të të drejtave procedurale të të akuzuarit si të drejta themelore të njeriut, por një gjë e tillë nuk vërehet kur bëhet fjalë për të drejtat e viktimës. Duhet gjetur patjetër mënyra të evitimit të viktimizimit sekondar në mënyrë që të inkurajohet qasja e viktimës drejt sistemit ligjor duke e përmirësuar përshtypjen e gjertanishme për këtë sistem si të huaj, të shtrenjtë dhe të largët për viktimën.
- Dokumentet dhe konventat ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, në veçanti me të drejtat e viktimës patjetër duhet të përmbajnë mekanizma serioze të implementimit të këtyre të drejtave duke e ndryshuar kështu përshtypjen e krijuar për këtë pjesë të të drejtës si “një mbrojtëse pa shpatë”. [10] Nga ana tjetër, hapësira mes të drejtave të njeriut dhe të drejtës penale ndërkombëtare (e cila shpesh karakterizohet si një “shpatë pa

mbrojtëse”) duhet të tejkalohet me qëllim të ofrimit të mbrojtjes dinjitoze jo vetëm të viktimave të shkeljeve të ligjeve ndërkombëtare penale, por edhe të shkeljeve të të drejtave të njeriut.

- Kompensimi i viktimës duhet të internacionalizohet dhe ndihmë e organizuar duhet t’i jepet këtij procesi në vendet ku është i nevojshëm implementimi praktik i rregullave të adoptuara në mënyrë që të tejkalohet eksperiencia e gjertanishme e promovimit teorik të të drejtave dhe mosrealizimit të tyre në praktikë. Sidoqoftë, roli i viktimës nuk guxon të kufizohet vetëm në kërkesën për kompensim të dëmit; një mendim i përbashkët duhet gjetur lidhur me mundësimin e participimit direkt të saj në të gjitha fazat e procesit penal.
- Sa i përket Maqedonisë si dhe vendeve tjera të rajonit që ballafaqohen me problemin e njëjtë, mendoj që është koha që këto vende ta pranojnë së pari terminin “viktimë” në legjislacionin e tyre si dhe ti sigurojnë të drejtat themelore të tyre për arritjen e balancës mes të akuzuarit dhe viktimës.

Duhet theksuar që viktima është shumë më e stigmatizuar nga vepra penale se sa vetë kryerësi i cili në rradhë të parë ka vendosur vetë ta kryejë veprën e kundërligjshme. Pozita sociale e viktimës së krimit për momentin nuk është aspak e volitshme dhe me këtë sqarohet arsyeja e refuzimit të raportimit të kriminalitetit duke u munduar kështu në mënyrë të heshtur ta tejkalojnë atë të keqe që u ka ndodhur. Kjo bëhet akoma më e vështirë dhe frustruese nëqoftëse sistemi nuk i siguron të drejtat e tyre dhe i vendos ato në një pozitë ri-viktimizimi. Shteti dhe shoqëria duhet të bëjnë ç’është e mundur për t’u ndihmuar viktimave ta tejkalojnë stigmën me të cilën ballafaqohen dhe të çlirohen prej saj dhe në këtë mënyrë, ta diskurajojnë kryerësin nga aktet e kundërligjshme duke stimuluar kështu krijimin e një vendi më të mirë për personat që kanë vuajtur dëme të ndryshme në një periudhë të errët të jetës së tyre.

Referencat

- 1 Kennard KL. The victim's veto: A way to increase victim impact on criminal case dispositions. *California Law Review* 1989 Mar; 77(2): 417-453.
- 2 Fenwick H. Procedural "rights" of victims of crime: Public or private ordering of the criminal justice process?. *The Modern Law Review* 1997 May; 60(3): 317-333.
- 3 Miers D. The responsibilities and the rights of victims of crime. *The Modern Law Review* 1992 Jul; 55(4): 482-505.
- 4 Ben-Shahar O. Blaming the Victim: Optimal Incentives for Private Prosecutions Against Crime. *Journal of Law, Economics & Organization* 1995 Oct; 11(2): 434-455.
- 5 Fiss OM. The awkwardness of the criminal law. *Human Rights Quarterly* 1989 Feb; 11(1): 1-13.
- 6 Sebba L. The victim's role in the penal process: A theoretical orientation. *The American Journal of Comparative Law* 1982; 30(2): 217-240.
- 7 Cutler AS. Why the good citizen avoids testifying. *Annals of the American Academy of Political and Social Science: Judicial Administration and the Common Man* 1953 May; 287: 103-109.
- 8 McKay F. Civil reparation in national courts for victims of human rights abuse. In: Lattimer M, Sands P, editors. *Justice for crimes against humanity*. Oxford: Hart Pub; 2003. p. 283-302.
- 9 Prindërit e vajzave të dhunuara janë të pakënaqur me vendimin e gjykatës (Родителите на силуваните незадоволни од пресудата), *Gazeta ditore Dnevnik*, 2008 Feb 26. URL: <http://dnevnik.com.mk>.
- 10 Bassiouni, MC. *Introduction to international criminal law*. New York: Transnational Publishers; 2003.
- 11 The UN Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power (1985). URL: http://www.unhchr.ch/html/menu3/b/h_comp49.htm
- 12 Draft basic principles and guidelines on the right to restitution, compensation and rehabilitation for victims of gross violations of human rights and fundamental freedoms (1997). URL: [www.unhchr.ch/Huridocda/Huridoca.nsf/0/42bd1bd544910ae3802568a20060e21f/\\$FILE/G0010236.doc](http://www.unhchr.ch/Huridocda/Huridoca.nsf/0/42bd1bd544910ae3802568a20060e21f/$FILE/G0010236.doc)
- 13 Draft basic principles and guidelines on the right to remedy and reparation for victims of violations of international human rights and humanitarian law (2000). URL: <http://www.alrc.net/doc/mainfile.php/documents/115/>

- 14 Statute of the International Criminal Tribunal for Yugoslavia. URL: <http://www.un.org/icty/legaldoc-e/basic/statut/statute-feb08-e.pdf>
- 15 *Prosecutor v. Tadić*, ICTY case number IT-94-1. URL: <http://www.un.org/icty/cases-e/index-e.htm>
- 16 The Rome Statute of the International Criminal Court. URL: http://www.icc-cpi.int/library/about/officialjournal/Rome_Statute_English.pdf
- 17 Reparation of victims. The home page of the ICC. URL: <http://www.icc-cpi.int/victimsissues/victimsreparation.html>
- 18 КРИВИЧЕН ЗАКОНИК – Kodi Penal, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.19, 30.03.2004
- 19 ЗАКОН ЗА КРИВИЧНАТА ПОСТАПКА – Ligji për Procedurë Penale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 15, 07.03.2005

Bibliografia

- 1** Cassese A. International criminal law. USA: Oxford University Press; 2003.
- 2** Chinkin CM. Due process and witness anonymity. The American Journal of International Law 1997 Jan; 91(1): 75-79.
- 3** DeFrancia C. Due process in international criminal courts: Why procedure matters. Virginia Law Review 2001 Nov; 87(7): 1381-1439.
- 4** Hutt, SH. In praise of public access: Why the government should disclose the identities of alleged crime victims. Duke Law Review 1991 Nov; 41(2): 368-414.
- 5** Kaiser G. Криминологија (Kriminologjia), Shkup: Aleksandria; 1996.
- 6** Kaszubinski M. The International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia, in Bassiouni (ed.), Post-Conflict Justice, New York 2002, 459-485.
- 7** Koblitz D. “The public has a claim to every man’s evidence”: The defendant’s constitutional right to witness immunity. Stanford Law Review 1978 Jul; 30(6): 1211-1242.
- 8** Law Reform Commission of Western Australia: The Adversarial System of Criminal Litigation (Chapter 7), Review of the Criminal and Civil Justice System, 51-60.
- 9** Leigh M. Witness anonymity is inconsistent with due process. The American Journal of International Law 1997 Jan; 91(1): 80-83.
- 10** Levmore S. The anonymity tool. University of Pennsylvania Law Review 1996 May; 144(5): 2191-2236.
- 11** Mackarel M. Framework of protective measures for victims and witnesses, balancing the rights of the accused, interpreting the rules of procedure and evidence in the light of the unique nature of the Tribunal. In Klip A, Sluiter G, editors. Annotated leading cases of international criminal tribunals, Student Edition, Oxford: Intersentia Uitgevers; 2005. p. 154-156.
- 12** May R. The collection and admissibility of evidence and the rights of the accused. In: Lattimer M, Sands P, editors. Justice for Crimes Against Humanity. Oxford: Hart Pub; 2003. p. 161-172.
- 13** Overy R. The Nuremberg trials: International law in the making, in Sands P, editor. From Nuremberg to the Hague – The future of international criminal justice, Cambridge: Cambridge University Press; 2003. p. 1-29.